




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr.105/23
Datë: 29.11.2023

Duke u bazuar në nenin 11 par. 3.1, nenet 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 par 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 29.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. LEJOHET, Përqendrimi i ndërmarrjeve Petrol Slovenska energetska druzba d.d., (Kroaci) dhe shoqëria mëmë Petrol Slovenska energetska druzba d.d. (Slloveni) lidhur me marrjen e kontrollit indirekt mbi asetet e Energospektar d.o.o. si dhe blerjen e tyre nga transportuesit Alfiko d.o.o., Invictus d.o.o., dhe Klement Transport Croatia d.o.o.

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me nenin 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro)

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 18.10.2023, me Nr. Prot. 487/23-01/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit përmes znj. Mrika Gashi, Përfaqësuese Ligjore lidhur me marrjen e kontrollit indirekt nga Petrol Slovenska energetska druzba d.d., (Kroaci) dhe shoqëria mëmë Petrol Slovenska energetska druzba d.d. (Slloveni) si dhe blerjen e tyre nga transportuesit Alfiko d.o.o., Invictus d.o.o., dhe Klement Transport Croatia d.o.o.

Procedurat e ndjekura:

1. Vlerësimi i Lëndës
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 03.11.2023
3. Njoftimi për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 03.11.2023

4. Më datë 26 shtator palët Petrol Slovenska d.d., dhe Transporuesit Alfiko d.o.o., Invictus d.o.o., Klement Transport Croatia d.o.o., kanë lidhur Kontratën për Transport Rrugor mbi asetet e Energostar d.o.o.

Petrol Slovenska d.d., Lubjanë, është shoqëri aksionare e regjistruar sipas ligjeve të Sllovenisë, me numër të regjistrimit të biznesit 5025796000 dhe adresë në; Dunajska cesta 50 1000 Ljublanë Slloveni. Petrol Slovenska është kompania më e madhe sllovene e energjisë sa i përket Petrol Group.

Aktiviteti dominues i kompanisë Petrol d.d., Lubjanë, është shitja e karburanteve dhe derivateve, mallrave dhe shërbimeve, si dhe energji dhe solucione.

Energospektar d.o.o., është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionit kroat, me seli në Zagreb, Kroaci, me adresë të regjistruar në Rr. Matije Divkovića 71, 10.090, e regjistruar pranë regjistrimit përkatës tregtar me numër të biznesit 030092057. Energospektar është pronar i automjeteve cisternë, lidhur me të cilat ka lidhur kontratë për shitjen e tyre me kompanitë transportuese si më poshtë;

Alfiko d.o.o., është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionit kroat, me seli në Zagreb, Kroaci, me adresë të regjistruar në; Ulica brace Cvijica 22, e regjistruar pranë regjistrimit përkatës tregtar me numër të biznesit 080856250.

Invictus d.o.o., është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionit kroat, me seli në Zagreb, Kroaci, me adresë të regjistruar në; Livadarska ulica 22, e regjistruar pranë regjistrimit përkatës tregtar me numër të biznesit 010078325.

Klement Transport Croatia d.o.o., është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionit kroat, me seli në Zagreb, Kroaci, me adresë të regjistruar në; Kanalska ulica H2, e regjistruar pranë regjistrimit përkatës tregtar me numër të biznesit 081526280

Baza juridike:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- a. Qarkullimi i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
- b. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.
- c. Parashtruesit e kërkesës kanë për qëllim të ekzekutojnë Marrëveshjen lidhur me marrjen e kontrollit indirekt dhe blerjen e asetëve, (automjetet/tanket–cisternë).
- d. Kërkesa për përqendrim është bërë për arsye se Aplikuesi (kompania mëmë) ka filiale të regjistruar në Republikën e Kosovës.

Analiza e Konkurrencës

Transaksioni i propozuar ka të bëjë me marrjen e kontrollit indirekt mbi automjetet cisternë si pjesë e fituar e sipërmarrjes nga Petrol Slovenska d.d. Përkatësisht, objekt i

transaksionit janë automjetet cisternë të cilët janë në pronësi të mbi Energostar d.o.o., dhe e cila ka lidhur marrëveshje për shitjen e tyre me Transportuesit Alfiko d.o.o., Invictus d.o.o., Klement Transport Croatia d.o.o. Automjetet cisternë janë përdorur më parë nga vetë Energostar për ofrimin e shërbimeve ndaj Petrol ose filialeve të saj Petrol Kroacia, për këtë arsye cisternat janë shënuar edhe me etiketat e Petrol.

Meqenëse Petrol kishte pësuar disa ndryshime organizative, Petrol propozoi që Energospektar të negocionte me blerës tjerë për shitjen e automjeteve cisternë dhe Petrol d.d., ishte i përgatitur të negocionte me blerësit dhe të lidhë kontrata të veçanta përkatësisht Marrëveshje transporti për përdorimin e shërbimeve të transportit të ofruara nga automjetet cisternë të cilat i nënshtrohen shitjes, sipas një marrëveshje ekskluzive automjetet cisternë do të mbajnë etiketat e Petrol d.d., pra përmes këtyre kontratave Petrol fiton të drejtën ekskluzive për përdorimin e automjeteve /tankeve-cisternë, duke fituar kontroll indirekt mbi asetet e Energospektar, tani të Transportuesve.

Transaksioni si i tillë nuk do ndikojë në tregun e Kosovës, pra nuk do të kufizoj apo do të shtrembëroj konkurrencën në tregun përkatës, transaksioni i propozuar nuk mund të forcoj asnjë pozitë dominues në treg, për më tepër, meqenëse targeti nuk ka prezencë, tregu i Kosovës mbetet i pa ndikuar nga ky transaksion.

Tregu përkatës, mbetet i pandryshuar edhe pas transaksionit.

Tregu i produktit përfshin shërbimet e transportit të derivateve të naftës (automjetet/tanket-cisternë).

Tregu gjeografik para transaksionit, është tregu i Republikës së Sllovenisë dhe Kroacisë.

Tregu gjeografik pas transaksionit, është tregu i Republikës së Kroacisë.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës, nga transaksioni i realizuar.

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik të Republikës së Kroacisë, kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se pala e cila fiton kontrollin indirekt mbi asetet e kompanisë target ka një filiale të regjistruar në Republikën e Kosovës. Sipas vlerësimit të përqendrimit nga ky transaksion, nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk do të kenë efekt negativ në tregun kosovar, e rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në tregun përkatës.

Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar se transaksioni nuk paraqet efekte negative, në konkurrencë për arsye se ky transaksion /blerja nuk ndikon në forcimin e pozitës dominues të ndërmarrjes blerëse, tek operatorët ekonomik apo konsumatorët.

Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI**

Neime Binaku-Isufi

Kryetare


Kaltrina Sela
Zv. Kryetare



Nafije Osdautaj
Anëtare



Florent Mehmeti
Anëtar



Salihe Gashi-Loku
Anëtare



III. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva